



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Nr.01-060/01-10102/23 datë:24.04.2023



Npi – 01/183 datë: 26.04.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28, datë 04.06.2008); Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes; Nenin 13 dhe 17 të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi-01/155 të datës 27.04.2023, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në mbledhjen e mbajtur më: 26.04.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT
të mbajtur më datën: 26.04.2023 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja, znj.Albana Podvorica, Anëtarët e Komitetit: z.Asllan Beqaj, z.Hamëz Tërshani, z.Rexhep Gashi dhe znj.Arbenita Brahimi. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: znj.Albana Fazliu, drejtoreshë e DKRS-ë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit; znj.Albana Podvorica, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 29.03.2023,
2. Informatë rreth aktiviteteve për shënimin e ditës së Tokës nga DSHP dhe DKRS,
3. Informatë nga DKA rreth mbajtjes së ligjëratave me klasë e 9-ta dhe 12-ta,
4. Raport rreth punës së Drejtorëve të shkollave, dhe braktisjen e shkollës nga nxënësit, nga DKA,
5. Informatë nga DKA për përfundimin e periodës së dytë të korikulës,
6. Informate rreth aktiviteteve dhe organizimeve për të rinjtë nga DKRS,
7. Informatë nga DKRS mbi gjendjen dhe mirëmbajtjen e terreneve sportive,
8. Informatë nga DKA rreth transportit të nxënësve.

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, për disa pika të rendit të ditës, nuk janë prezent as drejtorët e as zyrtarët, unë e kërkoj ndihmën e juaj nëse mund të diskutojmë për pikat që nuk i kemi prezent drejtorët.

znj.Arbenita Brahimi; Përshëndetje, unë po propozoj që për pikat për të cilat drejtoresha është prezent me i qitë të parat në rendin e ditës.

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Materiali u ka shkuar të gjithëve nëpër E-mailat e tyre zyrtarë, unë nuk kamë ndonjë informatë shtesë nga ta.

z.Asllan Beqaj; Përshëndetje, e përkrahu propozimin e Arbenitës.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht miratoi rendin e ditës, me ndryshimet që pikat 6 dhe 7 të dalin si pika 2 dhe 3 si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 29.03.2023,
2. Informate rreth aktiviteteve dhe organizimeve për të rinjtë nga DKRS,
3. Informatë nga DKRS mbi gjendjen dhe mirëmbajtjen e terreneve sportive,
4. Informatë rreth aktiviteteve për shënimin e ditës së Tokës nga DSHP dhe DKRS,
5. Informatë nga DKA rreth mbajtjes së ligjëratave me klasë e 9-ta dhe 12-ta,
6. Raport rreth punës së Drejtorëve të shkollave, dhe braktisjen e shkollës nga nxënësit – DKA,
7. Informatë nga DKA për përfundimin e periodës së dytë të korikulës,
8. Informatë nga DKA rreth transportit të nxënësve.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 29.03.2023

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rexhep Gashi; Te procesverbalit i mbledhjes së kaluar te pika në fillim duhet të përmirësohet se unë nuk kam kërkuar pauzë dy orësh, por unë vetëm e kam përkrahur parafolësin.

z.Asllan Beqaj; Unë nuk kam kërkuar pauzë dy orësh por të shikohet stenogrami dhe të sqarohet.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht, miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KAKRS-së e mbajtur më 29.03.2023, me vërejtje.**

Pika 2

Informate rreth aktiviteteve dhe organizimeve për të rinjtë nga DKRS

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Albana Fazliut.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Përshëndetje Informatën e keni marrë me E-mail në formë të shkruar. Në vazhdim lexoi Informatën dhe bëri disa komente lidhur me Informatën, (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, një pyetje konkrete, çka konkretisht me Klubin Letrarë? Ndarja e 44 mijë eurove a janë vetëm për sport apo janë edhe për Kulturë.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Janë vetëm për Sport.

Pika 3

Informatë nga DKRS mbi gjendjen dhe mirëmbajtjen e terreneve sportive

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Albana Fazliut.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Edhe për këtë pikë materialin e keni marrë me E-mail në formë të shkruar. Në vazhdim tha se është lajm i mirë se ka filluar ndërtimi i Stadionit si dhe Bibliotekës, më tutje e lexoi Informatën dhe tha nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. (Shih dokumentin).

z.Hamëz Tërshani; Ky investim për sport te Stadioni, a është menduar se si ka me u menaxhuar, dhe tjetra qysh ka me u mirëmbajtur Halla Sportive?

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Buxhetin për nxemje nuk e kam të planifikuar.

Pika 4

Informatë rreth aktiviteteve për shënimin e ditës së Tokës nga DSHP dhe DKRS

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Albana Fazliut.

znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS; Për këtë pikë unë nuk jam e përgatitur sepse nuk është organizim i DKRS-së. Drejtorja për Shërbime Publike e ka për obligim këtë pjesë.

Pika 5

Informatë nga DKA rreth mbajtjes së ligjëratave me klasë e 9-ta dhe 12-ta

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë. Në vazhdim tha meqenëse për pikat në vazhdim nuk e kemi prezent drejtoreshën, atëherë unë propozoj që ti hjekim nga rendi i ditës pikat 6, 7 dhe 8. Ne mundemi edhe me e pyet drejtoreshën në mbledhjen e Kuvendit.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimitisht vendosi që pikat 6, 7 dhe 8 të hiqen nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk është prezent drejtoresha e DKA-së.**

Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 10:44h

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Albana Podvorica

